



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

“Nderi i Kombit”: Nderohen me dekoratën e lartë mjeshtri Besim Zekthi dhe Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore

2017-11-14 16:21:00



Ansambli Popullor është tashmë “Nder i kombit”, dekoratë e lartë e dhënë nga presidenti Ilir Meta në kuadër të 60-vjetorit të krijimit të këtij institucioni kulturor. Motivi është për kontributet e çmuara dhe interpretimet e shkëlqyera në më shumë se gjysmë shekulli, duke pasur një ndikim të jashtëzakonshëm, të ndjeshëm dhe të patjetërsueshëm në zhvillimin artistik e kulturor në mbarë vendin.

Ansambli Popullor është tashmë “Nder i kombit”, dekoratë e lartë e dhënë nga presidenti Ilir Meta në kuadër të 60-vjetorit të krijimit të këtij institucioni kulturor.

Motivi është për kontributet e çmuara dhe interpretimet e shkëlqyera në më shumë se gjysmë shekulli, duke pasur një ndikim të jashtëzakonshëm, të ndjeshëm dhe të patjetërsueshëm në zhvillimin artistik e kulturor në mbarë vendin. Ministria e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro lexoi motivacionin : “Për rolin e luajtur si ambasador i kulturës jashtë Shqipërisë, nëpërmjet përcjelljes së vlerave më të qenësishme të folklorit shqiptar e trashëgimisë sonë shpirtërore në gjithë botën”.

Gjithashtu Presidenti i Republikës çmoi me Dekoratën “Nderi i Kombit” kërcimtarin, dhe mjeshterin e valles popullore shqiptare Besim Zekthi në vlerësim të kontributit shumëvjeçar si solist me nivel të lartë interpretativ dhe mjeshtër veçantë artistike të valleve shqiptare; për pasurimin e fondit të krijimtarisë koreografike dhe përçimin tek brez i ri artistëve të rinj, si dhe për promovimin denjësisht të vlerave të mirëfillta të trashëgimisë sonë kulturore jashtë vendit.